



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:915056

Datë: 27.11.2024

Numri i dokumentit: 06521200

C.nr.843/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Feim Bytyqi, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditësit K në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim G.B, kundër të paditurit Sh.H.C nga Rahoveci, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 1,547.53 Euro, në seancë gjyqësore me datë 25.11.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditësit K në Prishtinë, në lidhje me këtë çështje juridike konsiderohet se është tërhequr.

A r s y e t i m

Paditësi paditësit K në Prishtinë, ka ushtruar padinë kundër të paditurit Sh.H.C nga Rahoveci, për shkak të kompensimit të dëmit.

Në bazë të padisë së paditësve, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor për datë 25.11.2024.

Edhe pse paditësi ftesën e ka pranuar me rregull, dhe ftesës nuk i është përgjigjur, e as që e ka arsyetuar mungesën e tij, ndërsa për të paditurën askush, andaj kjo gjykatë duke u mbështetur në dispozitat e nenit 423.3 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke konsideruar se padia e paditësve është tërhequr.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 423.3 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.843/2023, dt 25.11.2024

B. Profesional  
Armond Qmega

Gjyqtari  
Feim Bytyqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtinë – Divizioni Civil.